

Ballafaqimi me refuzimet me rastin e kërkimit të vendit për mësim të profesionit

Kur shpallet një vend i lirë, zakonisht konkurrojnë shumë persona për këtë vend. Por vetëm një person pranohet në këtë vend. Të tjerët jo.

Edhe te vendet për mësim të profesionit nuk është ndryshe. Varësisht prej rajonit dhe profesionit, konkurrojnë pak ose shumë persona për një vend. Shpesh madje edhe disa qindra. Të gjithë duhet të llogarisin me refuzim, edhe pse ndoshta janë të përshtatshëm për vendin për mësimin e profesionit. Refuzimi i aplikacionit për vendet për mësim të profesionit nuk janë të jashtëzakonshme dhe kjo nuk ka të bëjë patjetër diçka me ju personalisht: për këtë arsye mos humbni kurajën. Ndoshta refuzimi ka pasur ndonjë arsye, në të cilin nuk keni mundësi ndikimi:

- Ndërmarrja është stërngarkuar me aplikacione dhe i ka zgjedhur ata me nota (shkollore) absolutisht më të mira.
- Në profesionin tuaj të preferuar ka zakonisht pak vende për mësim të profesionit.
- Në rajonin tuaj të banimit ka vetëm pak vende për mësim të profesionit të preferuar.
- Ju konkurroni për një "Profesion të ëndrrave" – aty konkurrenca është veçanërisht e madhe.
- Aplikacioni juaj ka mbërrirë me vonesë. Vendi për mësim të profesionit tashmë i është ndarë dikujt tjetër.

Këshilla:

- Kontrolloni dokumentet tuaja të aplikimit dhe diskutoni ato me dikë nga rrethi juaj, apo me një specialist. Është dosja juaj në rregull (në tërësi, në drejtshkrim, në paraqitje)? Çka mund të përmirësohet ose të plotësohet, në mënyrë që dosja juaj, të dallohet në mesin e të gjitha aplikimeve të tjera? (krahaso gjithashtu www.myberufswahl.ch hapi 6.3)
- Rikujtojeni edhe njëherë bisedën gjatë intervistës, çka ka shkuar mirë, çka jo? Çka do të mund të bëni më mirë në rast të një bisede të ardhshme? Ushtroni këtë lloj bisede.
- Bisedoni me prindërit, mësimdhënësit, këshilltarët për profesion ose me këshilltarët, shokët dhe shoqet, kolegët e tjerë që kërkojnë vende për mësim të profesionit etj., mbi përvojat e tyre.
- Merrni guximin dhe pyetni në ndërmarrje, pse nuk ju kanë marrë parasysh. Eventualisht mund t'ju ndihmojë dikush prej tyre.
- Asnjë njeri nuk është i lindur vetëm për një profesion. Shikoni edhe profesione të ngjashme, mendoni për rrugë alternative të aftësimin profesional, të cilat gjithashtu mund t'ju shpien në cak. Shfrytëzoni për këtë edhe Këshillimoren për Profesionet dhe Qendrën Informative për Profesionet. Qëndroni kureshtarë!

Shumë me rëndësi:

Mos u dorëzoni, interesohuni dhe aplikoni vazhdimisht. Vendet e hapura për mësim të profesionit i gjeni në internet.